



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 10

Tiranë – E premte, 17 janar 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 9.1.2025	Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike, për vitin 2025 735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 16.1.2025	Për lirim nga detyra..... 737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 16.1.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 665, datë 24.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e pasojave të shfuqizimit të ligjit nr. 13/2016, ‘Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë’” 737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 16.1.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 497, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, nga Ministria e Kulturës, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016”, të ndryshuar..... 738
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 16.1.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në shtabin ‘EUFOR’, në kuadër të operacionit ushtarak ‘ALTHEA’, të Bashkimit Evropian, në Bosnjë-Hercegovinë”, të ndryshuar..... 739
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 16.1.2025	Për shpalljen e zonës me numra pasurie 3/326 dhe 3/665, të zonës kadastrale 8240, si zonë për zhvillim, me qëllim ndërtimin e banesave sociale, në pronësi të Bashkisë Tiranë..... 739
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 16.1.2025	Për funksionimin, kohëzgjatjen, organizimin dhe detyrat e Komisionit të Verës..... 740



VENDIM
Nr. 21, datë 9.1.2025

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË
PËRGJITHSHME TË KREDIVE TË REJA
PËR KATEGORITË PRIORITARE TË TË
PUNËSUARVE PËRFITUES NË
ADMINISTRATËN PUBLIKE,
PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 64/3 e 64/5, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për nëpunësit civilë dhe nëpunësit e tjerë të administratës publike, për vitin 2025, janë, gjithsej, 530 (pesëqind e tridhjetë), të ndara, si më poshtë:

a) 90 (nëntëdhjetë) kuota, Ministria e Brendshme;

b) 90 (nëntëdhjetë) kuota, Ministria e Arsimit dhe Sportit;

c) 80 (tetëdhjetë) kuota, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për mjekë dhe infermierë;

ç) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

d) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Mbrojtjes;

dh) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

e) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

ë) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Drejtësisë;

f) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

g) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Financave;

gj) 30 (tridhjetë) kuota, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

h) 30 (tridhjetë) kuota, Kryeministria.

2. Përfituesit, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “ë” e “h”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përfituesit, sipas shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Përfituesit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe në tabelën bashkëlidhur, përzgjedhja e tyre realizohet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar nga institucioni përfitues, për të realizuar numrin e kuotave të përcaktuara.

6. Punonjësit e administratës publike të përzgjedhur përfitojnë kredi të lehtësuara me interes 0%.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Tabela nr. 1

PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T’U TRAJTUAR ME
KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	50
A	Nuk disponon banesë në pronësi	
B	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C	Punonjës që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	
Ç	Punonjës që banon në banesë që do të priset, pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	25
A	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se dy vjet të punësuar në administratën publike, në momentin e aplikimit	
B	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se shtatë vjet të punësuar në administratën publike, në momentin e aplikimit	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	I përkasin kategorisë së pagës sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
B	I përkasin kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
C	I përkasin kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
Ç	I përkasin kategorisë së pagës sipas vendimit nr. 424, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave	

Tabela nr. 2

PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T’U TRAJTUAR ME
KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS PËR MINISTRINË E MBROJTJES

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	50
A	Nuk disponon banesë në pronësi	
B	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C	Punonjës që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	
Ç	Punonjës që banon në banesë që do të priset, pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	25
A	Punonjës, që i përket kategorisë “familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
B	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se dy vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se pesë vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit.	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	I përkasin kategorisë së pagës sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.06.2024, të ndryshuar	
B	I përkasin kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024	
C	I përkasin kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave	



Tabela nr. 3

PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS PËR MINISTRINË E BRENDSHME

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	50
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
Ç	Punonjës që banon në banesë që do të prishet, pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	25
A	Punonjës, që ka jo më pak se një vit i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit e që bën pjesë në përkufizimin e pikës 54, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”	
B.	Punonjës, të cilët kanë jo më pak se pesë vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C.	Punonjës, të cilët i përkasin kategorisë “Familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
Ç	Punonjës, të cilët i përkasin kategorisë “Të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç”	
D	Familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	25
A.	I përkasin kategorisë së pagës sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
A.1	I përkasin kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1, ose ekuivalente me to.	
A.2	I përkasin kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2, ose ekuivalente me to.	

VENDIM

Nr. 33, datë 16.1.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Dorian Tola, zëvendësministër i Mbrojtjes, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 34, datë 16.1.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 665, DATË 24.10.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E PASOJAVE TË SHFUQIZIMIT TË LIGJIT NR. 13/2016, ‘PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE NË SPORTELE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 14 e 15, të ligjit nr. 100/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, e të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “c”, të pikës 4, të vendimit nr. 665, datë 24.10.2024, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:



“ç) sendeve të luajtshme të ADISA-s, të cilat gjenden në ambientet, që u përkasin bashkive Tiranë, Kamzë, Kavajë, Shkodër, Kukës, Malësi e Madhe, Mat, Belsh, Divjakë, Patos, Roskovec, Tepelenë, Himarë, Kolonjë, Librazhd, Pogradec, Maliq, Përmet dhe Gjirokastrë. Këto sende të luajtshme u transferohen bashkive përkatëse.”.

2. Ngarkohen ADISA, si dhe bashkitë Tiranë, Kamzë, Kavajë, Shkodër, Kukës, Malësi e Madhe, Mat, Belsh, Divjakë, Patos, Roskovec, Tepelenë, Himarë, Kolonjë, Librazhd, Pogradec, Maliq, Përmet dhe Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 35, datë 16.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 497, DATË 13.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË ISH-GODINËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE, NGA MINISTRIA E KULTURËS, KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT, INSTITUCIONE TË RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR. 84/2016”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 497, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, nga Ministria e Kulturës, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në titull dhe në përmbajtje, emërtesa “Ministria e Kulturës” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” dhe emërtesa “Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” zëvendësohet me emërtesat “Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.

2. Në titullin e vendimit, pas fjalëve “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, ...” shtohen “...të një pjese...” dhe hiqen fjalët “...institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016”.

3. Në pikën 1, pas fjalëve “Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, ...” shtohen “...të një pjese...”.

4. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët “Ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve” zëvendësohen me “Një pjesë e ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”;

b) fjalët “...deri në përfundim të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë (procesi i *vetting*-ut)” zëvendësohen me “...deri më 30.9.2025”.

5. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin të lidhin një marrëveshje, ku të përcaktohen modalitetet e përdorimit dhe të vënies në dispozicion të një pjese të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, si dhe kalimi kapital i pajisjeve të zyrave, sipas legjislacionit në fuqi.”.

6. Pika 5 shfuqizohet.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 37, datë 16.1.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË
SHTABIN ‘EUFOR’, NË KUADËR TË
OPERACIONIT USHTARAK ‘ALTHEA’,
TË BASHKIMIT EVROPIAN, NË
BOSNJË-HERCEGOVINË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 145, datë 20.2.2013, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në shtabin ‘EUFOR’, në kuadër të operacionit ushtarak ‘ALTHEA’, të Bashkimit Evropian, në Bosnjë-Hercegovinë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dërgimin me mision në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit ushtarak “ALTHEA”, të Bashkimit Evropian:

a) të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin “EUFOR”;

b) të 30 (tridhjetë) ushtarakëve në nivel “togë këmbësorie” nga Forca Tokësore e Republikës së Shqipërisë, në përbërje të kompanisë së pestë të manovrës së batalionit kinetik të Turqisë.”.

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjala “... përfaqësuesi ...” zëvendësohet me “... përfaqësuesve ...”;

b) Pas fjalëve “... aftësive mbrojtëse ...” shtohen “... si dhe garantimi i një mjedisi të sigurt për rritjen dhe forcimin e stabilitetit të shoqërisë në Bosnjë-Hercegovinë ...”.

3. Në pikën 3, togfjalëshi “... deri në 26 shkurt 2025 ...” zëvendësohet me “... deri në 31 dhjetor 2028 ...”.

4. Në pikën 4 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në fjalinë hyrëse, fjala “... përfaqësuesi ...” zëvendësohet me “... përfaqësuesit ...”;

b) Në shkronjën “a”, shifra 6000 (gjashtë mijë) zëvendësohet me 12 000 (dymbëdhjetë mijë);

c) Në shkronjën “e”, pas fjalëve “... në rast ...” shtohen “... thyerje disipline ...”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

III. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 38, datë 16.1.2025**

**PËR SHPALLJEN E ZONËS ME NUMRA
PASURIE 3/326 DHE 3/665,
TË ZONËS KADASTRALE 8240, SI ZONË
PËR ZHVILLIM, ME QËLLIM
NDËRTIMIN E BANESAVE SOCIALE,
NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës me numra pasurie 3/326 dhe 3/665, të zonës kadastrale 8240, në pronësi të Bashkisë Tiranë, si zonë e përshtatshme për zhvillim, me qëllim ndërtimin e banesave sociale, si



pjesë e fondit publik të banesave sociale, në pronësi të Bashkisë Tiranë.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për financimin dhe ndërtimin e banesave të reja të përshtatura në apartamente, sipas normave të strehimit, në kuadër të strehimit social.

3. Ngarkohet Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 39, datë 16.1.2025

**PËR FUNKSIONIMIN, KOHËZGJATJEN,
ORGANIZIMIN DHE DETYRAT E
KOMISIONIT TË VERËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 86/2022, “Për vreshtarinë dhe verën”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave për funksionimin, organizimin, kohëzgjatjen dhe detyrat e Komisionit të Verës.

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ata të parashikuar në ligjin nr. 86/2022, “Për vreshtarinë dhe verën” (në vijim, ligji për vreshtarinë dhe verën).

II. ORGANIZIMI I KOMISIONIT TË VERËS

1. Emërimi i anëtarëve të Komisionit të Verës bëhet për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi, por jo më shumë se 1 (një) herë.

2. Kërkesa për të qenë anëtar, si ekspert nga fusha akademike ose nga institucionet kërkimore-shkencore ose të pavarura, bëhet *online* në faqen zyrtare të internetit të ministrisë, në adresën zyrtare të publikuar, në vijim të një procedure konkurrimi, brenda 20 (njëzet) ditëve nga publikimi i njoftimit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, si më poshtë vijon:

a) kërkesa për kandidim, si anëtar i Komisionit të Verës, ku përcaktohet adresa e kandidatit dhe posta elektronike, me qëllim njoftimin për miratimin ose jo të kërkesës;

b) dokumenti i identifikimit;

c) diploma “Master i shkencave” ose të barasvlershëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ç) librezë, e cila vërteton eksperiencën në punë;

d) jetëshkrimi;

dh) certifikata trajnimit dhe çdo dokument tjetër, që provon kontributin dhe njohuritë në fushën e vreshtarisë dhe verës, si dhe skemave të cilësisë.

3. Në qoftë se kërkesa e kandidatit të interesuar nuk është paraqitur, në përputhje me kërkesat e pikës 2, të këtij kreu, kandidatit i kërkohet, nëpërmjet postës elektronike, që të korrigjojë pasaktësitë ekzistuese, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit. Kur kandidati i interesuar plotëson pasaktësitë brenda afatit të përcaktuar, kërkesa quhet e regjistruar nga dita që është dërguar. Kur kandidati i interesuar nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kandidatit bashkë me aktet e tjera.

4. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 19, të ligjit për vreshtarinë dhe verën, nga struktura përgjegjëse, e cila, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i thirrjes, përgatit një raport për kandidatët e interesuar, që kanë paraqitur kërkesë dhe ia dërgon për miratim ministrit. Ministri, brenda 10 (dhjetë) ditëve, miraton me urdhër përbërjen e Komisionit të Verës. Struktura përgjegjëse kryen menjëherë njoftimin e kandidatëve për përzgjedhjen ose jo të tyre, në formë shkresore dhe elektronike.

5. Kundër njoftimit për refuzimin e përzgjedhjes, kandidati i interesuar ka të drejtë të ankohet pranë ministrisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Shkarkimi i anëtarit të Komisionit të Verës përpara mbarimit të mandatit bëhet me urdhër të ministrit për një nga arsyet e mëposhtme:

a) nëse nuk paraqitet në 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të komisionit dhe nuk paraqet justifikime të provuara për këto mungesa;

b) kur dënohet me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;

c) kur bëhet i paafte mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën.



7. Mandati i anëtarit të Komisionit të Verës mbaron, kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) përfundon mandati 3-vjeçar i qëndrimit në detyrë;
- c) shkarkohet;
- ç) mbush moshën e pensionit;
- d) vdes.

8. Anëtari i Komisionit të Verës, që jep dorëheqjen, është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes pranë strukturës përgjegjëse për vreshtarinë dhe verën në ministri.

9. Struktura përgjegjëse merr masa për zëvendësimin e anëtarit të shkarkuar ose mandati i të cilit ka përfunduar, duke bërë njoftimin në faqen zyrtare të internetit të ministrisë, sipas procedurës së parashikuar në këtë kre.

III. FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË VERËS

1. Mbledhjet e Komisionit të Verës janë të mbyllura dhe thirren nga kryetari, si rregull, 1 (një) herë në muaj, në bazë të informacionit të marrë nga struktura përgjegjëse. Komisioni mund të mbledhet edhe kur shumica e anëtarëve paraqesin kërkesë me shkrim, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

2. Anëtarët e Komisionit të Verës njoftohen me shkresë zyrtare ose elektronike për datën dhe agjendën paraprake të mbledhjes, të paktën 7 (shtatë) ditë pune para ditës së mbledhjes.

3. Me përjashtim të pikës 1, të këtij kreu, kryetari mund të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të komisionit, brenda një periudhe më pak se 7 (shtatë) ditë pune nga dita e mbledhjes së Komisionit të Verës, kur:

- a) ndryshimet në specifikimet e produktit kërkojnë vlerësim të menjëhershëm për të mos penguar hedhjen në treg të produktit;
- b) nevojitet vlerësimi i komenteve për emërtime të regjistruara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- c) nevojitet, në çdo rast tjetër, një vlerësim i menjëhershëm i produktit.

4. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes së Komisionit të Verës realizohet kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve, duke përfshirë kryetarin dhe sekretariatit.

5. Procedura për mbledhjen e Komisionit të Verës është, si më poshtë vijon:

a) Çelet nga kryetari, i cili kërkon miratimin e agjendës paraprake me ndryshimet, nëse ka;

b) Sekretari paraqet verbalisht përpara komisionit një pasqyrë të përmbledhur të kërkesave të palëve, të fakteve dhe të provave, të depozituara para fillimit të shqyrtimit të çështjeve;

c) Kryetari shtron për diskutim me radhë të gjitha çështjet, që janë vendosur në agjendë;

ç) Kryetari i fton anëtarët të votojnë në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit e të shkëmbimit të opinionëve. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimmarrja. Votimi është i hapur në të gjitha rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin dhe nënshkruhet me fjalën “kundër”;

d) Vendimet e Komisionit të Verës miratohen me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm;

dh) Në rast se, rreth një çështjeje, votimi është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare;

e) Vendimi i Komisionit të Verës bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të ministrisë;

1.ë) Kryetari merr masa që, në fund të takimit, të përgatisë vendimin e arsyetuar, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votimin e tij. Një kopje e vendimit i dorëzohet sekretarit për t’ia bashkëlidhur dosjes së çështjes;

f) Procesverbali u bëhet i ditur të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe firmoset brenda 5 (pesë) ditëve nga data e mbledhjes;

g) Dokumentacioni i prodhuar gjatë të gjithë procedurës u nënshtrohet rregullave në fuqi për arkivat.

IV. DETYRAT E KOMISIONIT TË VERËS

1. Detyrat e kryetarit të Komisionit të Verës përfshijnë:

a) organizimin dhe drejtimin e punës së Komisionit të Verës;

b) thirrjen e mbledhjeve të Komisionit të Verës;

c) kryesimin e mbledhjeve të Komisionit të Verës;

ç) përcaktimin e agjendës paraprake të mbledhjeve të Komisionit të Verës;

d) monitorimin e afateve procedurale për aplikimet, në zbatim të ligjit për vreshtarinë dhe verën, dhe të këtij vendimi;

dh) përfaqësimin e Komisionit të Verës;

Kryetari mund të paraqesë në rendin e ditës të mbledhjes çështje të tjera, që nuk janë të përfshira në



agjendën e paraqitur paraprakisht, nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm.

2. Struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në ministri, në rolin e sekretariatit të Komisionit të Verës, përveç detyrave të parashikuara në pikën 3, të nenit 18, të ligjit për vreshtarinë dhe verën, kryen edhe detyrat, si më poshtë vijon:

a) mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të komisionit;

b) ndjek afatet procedurale dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin për vreshtarinë dhe verën e në këtë vendim dhe informon në kohë kryetarin;

c) përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së komisionit nga ana logjistike dhe administrative;

ç) është përgjegjëse për dosjet e kërkesave të depozituara, përcjelljen e tyre për shqyrtim pranë komisionit, si kërkesat për regjistrim, kërkesat për të ndryshuar specifikimet, për vërejtjet ose kundërshtimet;

d) ndjek ekzekutimin e vendimeve të komisionit dhe dërgimin zyrtar të vendimeve në adresat përkatëse, duke njoftuar komisionin lidhur me dërgimin zyrtar të vendimeve në destinacion;

dh) u komunikon anëtarëve me *email* orën dhe datën e mbledhjes, së bashku me rendin e ditës;

e) përgatit njoftimet e Komisionit të Verës për palët, lidhur me paraqitjen e argumenteve, prapësimeve dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm, të përcaktuar në ligjin për vreshtarinë dhe verën e në këtë vendim;

ë) mban minutat e takimit, procesverbalin e mbledhjes, listën e pjesëmarrësve dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara nga kryetari i komisionit;

f) shpërndan procesverbalin tek të gjithë anëtarët e komisionit dhe siguron firmosjen nga të gjithë, brenda 5 (pesë) ditëve punë;

g) mban të gjithë dokumentacionin e Komisionit të Verës, ku përfshihen edhe kërkesat për regjistrim, kërkesat për të ndryshuar specifikimet, për vërejtjet ose kundërshtimet dhe vendimet.

3. Çdo anëtar i komisionit ka të drejtë të propozojë çështje të tjera për diskutim, të ndryshme nga ato të parashikuara në agjendën paraprake.

4. Anëtarët e komisionit detyrohen:

a) të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit të Verës ose të njoftojnë, deri në 1 (një) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje, arsyen e mungesës;

b) të kryejnë vlerësimet për kërkesat për regjistrim të një vere me TGJ-në ose EO-në, sipas parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në ligjin për vreshtarinë dhe verën;

c) të kryejnë vlerësimet për kërkesat për mbrojtje të termit tradicional për EOM-në ose TGJM-në;

ç) të kryejnë çdo detyrë tjetër, të përcaktuar në ligjin për vreshtarinë dhe verën.

5. Kryetari, sekretariati dhe anëtarët e komisionit detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit rreth kërkesave për regjistrim, kërkesave për ndryshimin e specifikimeve, vërejtjeve dhe kundërshtimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

